



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHKOLLA E MAGJISTRATURËS
KËSHILLI DREJTUES

Nr. 475/
14 prot.

Tiranë, më 28. 3. 2025

V E N D I M

Nr. 5, datë 28.3.2025

P Ë R

**DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 36, DATË 27.9.2024, "PËR
MIRATIMIN E PEDAGOGËVE TË JASHTËM, PEDAGOGËVE NË DISPOZICION,
SPECIALISTËVE DHE ASISTENT PEDAGOGËVE TË PROGRAMIT TË FORMIMIT
FILLESTAR PËR VITIN AKADEMIK 2024 – 2025"**

Në mbështetje të nenit 248 të ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", neneve 28, 29 dhe 30 të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", vendimit nr. 36, datë 27.9.2024 të Këshillit Drejtues, si dhe të Rregullores së Brendshme të Shkollës së Magjistraturës, Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës, i mbledhur më datë 28.3.2025,

V E N D O S I:

1. Të miratojë znj. A M në grupin e pedagogëve të klinikës ligjore që zhvillohet gjatë vitit të dytë të Formimit Fillestar.
2. Të miratojë zëvendësimin e z. D K si titullar i lëndës "Ndërmjetësimi dhe arbitrazhi" me znj. A M
3. Të miratojë znj. N P si pedagoge në lëndën "Ndërmjetësimi dhe arbitrazhi".
4. Të miratojë znj. M Z si pedagoge të jashtme në lëndën "I mituri dhe viktima".
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.